

URDHËR
Nr. 5504/2, datë 14.9.2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 5591, DATË 5.8.2011 “PËR KRIJIMIN E
KOMISIONIT DISIPLINOR TË PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË”**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 51 të ligjit nr. 10 031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbarrimor gjyqësor privat”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 5591, datë 5.8.2011 “Për krijimin e komisionit disiplinor të përmbarruesve gjyqësorë privatë”, në pikën 1, bëhet ndryshimi si më poshtë:

1. Z. Shaqir Hasani, avokat në cilësinë e anëtarit, zëvendësohet me z. Arben Vani, avokat në cilësinë e anëtarit.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij urdhri Komisionit Disiplinor të Përmbarruesve Gjyqësorë Privatë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi